

**AKT-THEMELIMI DHE STATUT I**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“BAUFIXIT” sh.p.k**

**KREU I**

**Dispozita të Përgjithshme  
Neni 1**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Baufixit” sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe ligjit nr.9723 dt.03.05.2007 per “Qendren Kombetare te Rregjistrimit”

Sot, më 09.03.2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Baufixit” sh.p.k.**


**Shoqeria themelohet nga 2 (dy) ortake.**

- **ERMAL SULA**, i biri i Osmën dhe Zimbile, i dtl.14.08.1986, lindur ne Goriçan Berat dhe banues ne Berat, fshati Ura e Kuçit, mbajtes i numerit personal te shtetasve: I60814014K.
- **ELIO VELESHNJA**, i biri i Edmond dhe Bukuri, i dtl.24.02.2002, lindur ne Durres dhe banues ne Durres ne adresë Durres, Bregu i Kanalit, Arapaj, banese private, mbajtes i numrit personal te shtetasve: K20224045W.

**Neni 2**  
**Emërtimi i shoqërisë është “BAUFIXIT” SH.P.K.**

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat te kufizuar.**

**Neni 4**



Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 të këtij statute krijohet me mjete private të themeluesve të saj

#### Neni 5

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**Baufixit**” sh.p.k në përputhje me krijimin e kësaj shoqërie dhe me legjislacion shqiptar, rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve në shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e shoqërisë.

#### Neni 6

Shoqëria “**Baufixit**” sh.p.k, është person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit në organet përkatëse. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara në dokumentat e krijimit të saj, kontratën dhe në këtë statut.

#### Neni 7

Shoqëria do të kryejë aktivitet me objekt:

-Import, eksport, prodhim, paketim dhe tregtim te materialeve te ndertimit(ngjites pllakash, hidroizolim, grafiato, stuko patinimi, fuge pllakash, boje etj).

-Prodhim dhe tregtim shtepia druri.

-Prodhim, tregtim, importim dhe eksportim, pllaka dhe hidrosanitare.

-Prodhim tregtim, importim dhe eksportim, gure natyrale, mozaike guri, objekte dekoruese, (vazo, çezma pishina, oxhaqe etj), perfshire ketu instalimin e ketyre pajisjeve e prodhimeve ne objekte.

-Perfaqesim , ndermjetesim me kompani te tjera vendase dhe te huaja, lidhje kontratash ne emer te kompanive qe perfaqeson.

-Te kryeje çdo veprimtari tjeter ne permbushje te interesave dhe nevojave te shoqerise dhe sipas dispozitave te statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

#### Neni 8

##### Selia e shoqërisë

Selia e shoqerise “**Baufixit**” sh.p.k do jete ne adresen: Arapaj Durres, lagjja “Bregu i Kanalit”, Zona Kadastrale:1031, Rr. “Martin Camaj” godine dy kateshe.

### **Neni 9**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e vetë të përcaktuar në këtë statut në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprimtarie shoqëria mund të çelë degë, filiale dhe zyra të saja të përfaqësimit brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendit ku është hapur.

### **Neni 10**

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj për të realizuar fitimin e saj duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit.

### **Neni 11**

Pjesmarrja në shoqëri nuk i pengon ortaket e të kenë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera e për të drejta të tjera pronësie.

Ortaket nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj tek kapitali themeltar.

### **Neni 12**

Të drejta kryesore të ortakeve janë:

1. Pjesëmarrja në administrimin e veprimtarisë së shoqërisë më përputhje me kontratën dhe statutin e vet ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij.
2. Pjesëmarrja në rezultatet e veprimtarisë së shoqërisë në çdo formë dhe sasi qoftë në përputhje me statutin dhe kontratën.
3. Pjesëmarrja në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
4. Të kërkojë t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen tregtare të shoqërisë si dhe të gjitha dokumentet e përpunuara të shoqërisë si bilancet, llogaritë ekonomike etj.
5. Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
6. Të emerojë dhe të shkakrojë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

### **Neni 13**

**Detyrimet e ortakeve janë:**

1. Pjesëmarrje në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara prej tij, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve që krijon ai.
2. T'i japë shoqërisë informacionet e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
3. Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

**KREU II**  
**Kapitali i Regjistruar**

**Neni 14**

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimtarisë kontabël dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

**Neni 15**

**Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqindmije ) lekë,  
Sasia e kuotave është 2, me vlerë nominale 50.000 leke**

**Kapitali i shoqerise zoterohet si me poshtë :**

- z. Ermal Sula      50 % të kapitalit të shoqerisë.  
z. Elio Veleshnja    50% të kapitalit të shoqerisë.

**Neni 16**


Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të saj, ortaket e shoqërisë kane të drejtën e rritjes në mënyrë proporcionale.

**Neni 17**

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkëshortëve, parardhësve dhe pasardhësve. Transferimi duhet të vërtetohet me akt notarial.

**Neni 18**

Shoqëria në emër të vetë është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj gjithmonë në përputhje me qellimin e objektit të veprimtarisë që ajo kryen.



Shoqëria mund të shesë pasuriose të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale. Ajo mund të ofrojë për garanci dhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

### **Neni 19**

Shoqëria krijon fonde rezervë ose fonde të tjera të vecanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

Shoqëria disponon mjetet e veta financiare. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj mbulohen nga fondet rezervë, fondet e tjera ose nga shumat themelte që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakeve, në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

### **KREU III**

#### **Viti Financiar, Llogaritë Vjetore, Ndarja e Fitimit**

### **Neni 20**

Çdo vit finansiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë finansiar ka filluar në ditën e regjistrimit shoqërisë dhe përfundon me 31 Dhjetor të atij viti.

### **Neni 21**

Pasqyrat Financiare vjetore të shoqërisë deklarohen brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

### **Neni 22**

Ortaku e përballon vetë humbjen e veprimtarisë së shoqërisë në të ardhmen.

### **Neni 23**

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e citit finansiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen nga ortaku i shoqërisë. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit finansiar.

### Neni 24

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, pas zbritjes së të gjitha detyrimeve si dhe fondet e lëna për rezervë për nxitje ekonomike, për investime, për reklamën tregtare etj e përfiton 100% ortaku i vetëm i shoqërisë.

### KREU IV Administrimi

### Neni 25

Asambleja thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Asambleja mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë sipas kërkesave të nenit 82, pika 2 e ligjit nr. 9901. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

## **Administrimi i shoqërisë bëhet nga administratori.**

1. Asambleja emeron administratorin për një periudhë **5 (pesë) vjeçare** sipas parashikimeve të shkronjës ‘c’ të pikës **1 të nenit 81** dhe të nenit 95 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” . Emërimi do të jetë individual dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të zakonshme nga Asambleja .
2. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve prashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.
3. **z. ERMAL SULA ERMAL SULA**, i biri i Osmën dhe Zimbile, i dtl.14.08.1986, lindur ne Goriçan Berat dhe banues ne fshatin Ura e Kuçit Berat, mbajtes i numerit personal te shtetasve: I60814014K, **caktohet si administrator i shoqerise.**

### **Neni 26**

#### **Kompetencat e Administratorit janë:**

1. Miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadër të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamablesë, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar.
3. Miratimi i akteve normative që përcaktojnë raportet gjithin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
4. Përcaktimi i strukturës së aparatit të shoqërisë
5. Krijimi i organeve të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
6. Propozimi në mbledhjet e asamblës për krijimin e njësive, strukturave, filialeve, degëve dhe përfaqësive në qytet të tjera të vendit apo jashtë shtetit.
7. Përzgjedhja e Ekspertit Kontabël dhe anëtarëve të komisionit të likuidimit dhe paraqitja e propozimeve për miratim në asamble.

#### **KREU V**

**Prishja dhe Njoftimet**



7



### **Neni 27**

Kontrolli i shoqërisë mund të kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga ortaku i shoqërisë. Shkarkimi i Ekspertit Kontabël të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, ose kur bëhet e pamundur kryerja e detyrave.

### **Neni 28**

Në rast likuidimi të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe Vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qellim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

### **KREU VI**

#### **Dispozita të fundit**

### **Neni 29**

Ku statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të mbahen në një libër të veçantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

### **ORTAKET E SHOQERISE**

#### **“BAUFIXIT” SH.P.K.**

**Ermal Sula**



**Elio Veleshnja**

